

NJOFTIM PUNE

Balkan Finance Investment Group, BALFIN Group, është një nga grupet investuese më të rëndësishme dhe më të suksesshme në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Gjeografikisht, Grupi BALFIN është i pranishëm në Austri, Shqipëri, Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë, Maqedoni Veriore, Mali i Zi dhe Holandë, me afërsisht 6'000 punonjës në total. Aktivitetet e Grupit BALFIN përfshijnë zhvillimin dhe menaxhimin e pasurive të patundshme, shitjet me pakicë, industrinë minerare, sistemin bankar, turizmin, energjinë, logjistikën, etj. Grupi BALFIN po rritet në mënyrë të qëndrueshme dhe kontribuon në përmirësimin e jetesës së komuniteteve përmes zhvillimit ekonomik, prezantimit të ideve të reja, punësimit dhe investimeve sociale.

SPAR Albania është pjesë e Balfin Group dhe drejton rrjetin më të madh të shitjeve ushqimore me pakicë me të drejtën e ekskluzivitetit të emrit "SPAR".

Pozicioni: Specialist Ekspansioni

Departmenti: i Ekspansionit

Vendodhja: Tirane

Detyra dhe Përgjegjësi:

- Zhvillon dhe ekzekuton strategji/plane për zgjerimin e dyqaneve në përputhje me përparësitë e biznesit.
- Përcakton vendndodhjet e mundshme për hapjen e dyqaneve;
- Parashikon trendet e tregut, konsumatorëve dhe kanaleve, çështjeve/mundësive dhe veprimtarisë së konkurrentëve.
- Eksploron vendet më të mira për hapjen e dyqaneve, përfshirë analizën e tregut, studimin e fizibilitetit, vizitat në vendodhje dhe prezantimin e vendodhjes.
- Punon ngushtë me ekipe të ndryshme dhe drejton planin e punës për të arritur numrin e synuar të hapjeve të dyqaneve.
- Është pika kryesore e kontaktit për negociatat dhe diskutimet e qirasë dhe qiramarrjes me aktorët përkatës të brendshëm dhe të jashtëm.

Kërkesat:

a. Edukimi: Të ketë kryer studimet e larta.

b. Eksperiencat e punës: Minimumi 2 vite eksperiencë në pozicione të ngjashme, preferohet në Real-Estate.

c. Kualifikime të tjera:

- Njohuri të mira të tregut të pasurive të paluajtshme.
- Njohuri të mira të paketës Microsoft Office
- Aftësi shumë të mira komunikimi dhe ndërpersonale;
- Sistematik/e dhe i/e organizuar.
- I/e orientuar drejt rezultateve

Mënyra e aplikimit*: Kandidatët e interesuar janë të lutur të dërgojnë CV e tyre së bashku me letër motivimi në adresën e e-mailit hr@spar.al duke përcaktuar në subjekt pozicionin ose nëpërmjet postës në adresën: SPAR Tirana East Gate (TEG), Rruga Nationale Tiranë-Elbasan, Farkë (Lundër), Tiranë, Shqipëri.

Afati I aplikimit: 02/03/2022

**Të gjitha aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet të plotë sipas ligjit Nr .9887 vendosur nga Kuvendi i Shqipërisë për “Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.*